

VENDIM
Nr. 506, datë 30.7.2014

**PËR RISHPËRNDARJEN E FONDEVE NË BUXHETIN E VITIT 2014, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE, PËR
LUFTIMIN E KARKALECIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 17 të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitin 2014, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, të bëhet rishpërndarja e fondeve ndërmjet programeve, si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor 04220 “Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit”, në artikullin 602, të shtohet fondi prej 18 830 420 (tetëmbëdhjetë milionë e tetëqind e tridhjetë mijë e katërqind e njëzet) lekësh, për luftimin e karkalecit;

b) Në programin buxhetor 04250 “Zhvillimi rural, duke mbështetur bujqësinë, blegtorinë, agroindustrinë dhe marketingun”, artikulli 606, “Transferta në buxhetet familjare dhe individët”, të pakësohet fondi prej 18 830 420 (tetëmbëdhjetë milionë e tetëqind e tridhjetë mijë e katërqind e njëzet) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama